



Shpyllëzimet pa kriter, ndjekja e politikave të gabuara bujqësore, vlerësimi prioritar i germoplazmës së huaj me kapacitete të larta prodhuese, mungesa e programeve për ruajtjen dhe shfrytëzimin në mënyrë racionale të burimeve gjenetike autoktone, ndryshimet social - ekonomike, lëvizjet demografike, njohuritë e kufizuara për resurset gjenetike dhe mungesa e ruajtjes në kushtet e kontrolluara,



po çojnë në shkatërrimin e pamëshirshëm dhe të vazhdueshëm të tyre.

Faza 5. Krijimi i hartave dixhitale të zonave të eksploruara.



Për zonat e eksploruara ka filluar puna për krijimin e hartave digitale ku për çdo aksesion të gjetur do të dihet vendndodhja e kësaj pasurie të përbashket dhe të pazëvendësueshme për njerëzimin

.Identifikimi, vlerësimi dhe shtimi i aksesioneve të gjenotipeve e ekotipeve **me origjinë vendi të pemëve frutore** do të ndihmojë specialistët e rinj për ta ruajtur me kujdes dhe për të cuar përpara punën me resurset gjenetike .

**QENDRA E TRANSFERIMIT TË
TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË**

TEL 033/4144405

E- mail qttpemtarivlore@yahoo.com

RESURSET AUTOKTONE

TË PEMËVE FRUTORE



Vendi ynë përbën një vatër me burime të pasura gjenetike të cilat duhet të njihen, të mbrohen, të grumbullohen, të studjohen dhe të shfrytëzohen në dobi të kërkimit shkencor dhe prodhimit për të krijuar varitete të reja më të mira, të afta për të shfrytëzuar në maksimum mjedisin.



Fazat e punës me resurset gjenetike në QTTB Vlorë.


Faza 1. Eksplorimi (in situ)

Në fenofazën e pjekjes ekipet e eksplorimit (specialistët) me bashkëpunorë lokalë, marrin informacion, verifikojnë karakteristikat gjeografike, morfologjike, identifikojnë dhe plotësojnë dosjen që përmban skedën e eksplorimit dhe skedën e koleksionimit.

Këto bimë shërbejnë për të marrë material për shartim në pranverë.

Për çdo aksesione të etiketuar bëhen foto të bimës dhe të frutit.

Në fund të periudhës përgatitet skeda e çdo genotipi me rreth 10 të dhëna.



DARDHË



QERSHI

Vendndodhja e aksesioneve

Faza 2. Shtimi

Shumëzimi i materialit gjenetik me garanci identifikimi.

Përcaktohet metoda e shumëzimit:

Për ullirin mars - prill (me nebulizim ose me shartim).

Për hardhinë me shartim në muajin mars.

Për pemët frutore (me kalem në muajin mars ose me syth të fjetur në muajin gusht).

Për çdo aksesione bëhen 10 - 15 shartime për të siguruar 5 bimë.



Faza 3. Krijimi i koleksionit dhe studimi (ex-situ) me aksesione autoktone.

5 bimë për çdo aksesione vendosen në koleksion ose në repozitor.

Këtu bëhet studimi pomologjik, fenologjik me një skedë të plotë me rreth 50 të dhëna.

Këto të dhëna i bashkohen data baze

ndërkombëtare për resurset gjenetike autoktone (EURISCO).

Faza 4. Ndërtimi i blloqeve me aksesione të përzgjedhur me vlerë ekonomike.

Me sipërfaqe 2-3 dynym për çdo aksesione, të cilën ne e kemi zbatuar në hardhi dhe është planifikuar për pemët frutore.

Aktualisht nga puna kërkimore-studimore e kryer nga specialistët e Institutit të Pemëtarisë janë arritur të eksplorojnë, evidentohen dhe ruhen mbi 40 aksesione mollë, mbi 70



aksesione dardhë, 7 aksesione ftonj, mbi 30 aksesione kumbulla, 10 aksesione pjeshkë, 10 aksesione kajsi, 20 aksesione qersh, mbi 30 aksesione fiq, mbi 15 aksesione arra, 7 aksesione bajame, mbi 50 aksesione hardhi dhe mbi 20 aksesione ullinj.

Të gjithë genotipet e eksploruara të pemëve frutore, hardhisë dhe ullirit janë krijuar dhe përshtatur në mjedise ekologjike të caktuara. Është me interes të theksohet se çdo zonë ka kultivarët, format, apo biotipet, të cilët me kalimin e viteve kanë fituar veçori të konsoliduara.

